



2016

Rregullore e veçantë të obligimeve të vozitësve dhe garuesve

Në bazë të Statutit të Federatës e Auto Sporteve të Kosovës, Bordi Ekzekutiv i Federatës së Auto Sporteve të Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 02.04.2016 nxjerrë:

RREGULLOREN E VEÇANTË TË OBLIGIMEVE TË VOZITËSVE DHE GARUESVE NË AUTO DHE KARTING SPORTE TË FASK-UT

LICENCAT E GARUESEVE DHE VOZITËSVE PËR PJESËMARRJE NË AUTO DHE KARTING GARA

Neni 1.

Licencat garuesve dhe vozitësve mund të lëshohet nga FASK-u, e cila mban evidencën e rregullt, për të gjithë ata të cilët i përmbushin kushtet e parapara në bazë të kësaj Rregulloreje dhe Rregullores për Auto dhe Karting sporte.

Neni 2.

Licencat të cilat do të lëshohen janë:

- 1) Licencë ndërkombëtare, dhe
- 2) Licencë kombëtare

LICENCA NDËRKOMBËTARE TË VOZITËSVE

Neni 3.

Licencë ndërkombëtare do të lëshohen për vozitësit të cilët do të jenë pjesëmarrës në garat ndërkombëtare, jashtë territorit të Kosovës, e cila është e domosdoshme si kusht për pjesëmarrje në këto gara. Licencat ndërkombëtare lëshohen nga FASK-u sipas kushteve të përcaktuara në Shtojcën "L" (Appendix "L") të FIA-së.

Neni 4.

Licencat ndërkombëtare do të lëshohen në baze të kërkesave për lëshimin e licencave dhe atë:

1. Gradë A: e nevojshme për të gjitha automjetet me raport peshë/fuqi më pak ose e barabartë me 1 kg/KF.
2. Gradë B: e nevojshme për të gjitha automjetet me raport peshë/fuqi në mes të 1 dhe 2 kg/KF, dhe WTCC kampionatin e FIA-së.
3. Gradë C: e nevojshme për të gjitha makinat me një raport peshë/fuqi në mes të 2 dhe 3 kg/KF (përveç atyre të përmendura më lart) dhe të nevojshëm për FIA Auto-kros, Rallycross dhe kampionat për vozitës të kamionëve. Gjithashtu e nevojshme edhe për Historik Formula Një (Periudha G e tutje), Formula Dy (Periudha H e tutje), Indy Cars (Periudha G e tutje), Formula 5000 dhe Formula A cars (të gjitha), automjetet e Grupit C (të gjitha), CanAm cars (të gjitha) dhe Prototipet Sportive mbi 2 litra (Periudha G e tutje) pavarësisht nga raporti peshë/fuqi.
4. Gradë R: e vlefshme për të gjitha garat ne "rrugë" (reli, cross-country reli, gara malore dhe për garat tjera ne të cilat secilit garues i jepet start i veçant), të regjistruara në kalendarin ndërkombëtar e FIA-s.
5. Grade D: e nevojshme për të gjitha automjetet me raport peshë/fuqi më të madhe se 3 kg/KF (përveç atyre të përmendura më lart) dhe për të gjithë Club dhe Bronze seritë Ndërkombëtare të regjistruar nga FIA dhe për të gjitha automjetet historike ne gara rrethore (me përjashtim të atyre të përmendura më lart), pavarësisht nëse disa automjetet kanë raport peshë/fuqi më të vogël se 3 kg/FK.
6. Grade D1 (licencë të përkohshme ndërkombëtare për të garuar në një gare e cila është e miratuar nga FIA dhe është e regjistruar në kalendarin e FIA-s).



2016

Rregullore e veçantë të obligimeve të vozitësve dhe garuesve

7) FIA Junior - C (për garues të cilët janë të moshës mes 13 dhe 17 vjet, të cilët garojnë në garat të cilat janë të regjistruara në kalendarin FIA-s).

Bashkë-voztësve, përveç kategorisë për të cilën është lëshuar licenca, do të shënohet edhe termi "co. driver".

Licenca ndërkombëtare në Karting lëshohet në përputhje me rregulloret e FIA CIK.

LICENCA KOMBËTARE

Neni 5.

Licencat kombëtare do të lëshohen në bazë të kërkesës për lëshimin e licencave, dhe atë:

- 1) Licencë e kategorisë A, dhe
- 2) Licencë e kategorisë B.

Neni 6.

Licencë e kategorisë A do të lëshohet, të gjithë atyre poseduesve të licencës së tillë në periudhën paraprake, si dhe vozitësve për rezultatet përfundimtare të arritura në fund të vitit paraprak dhe atë:

- Auto Garat rrethore: nga vendi parë (1) deri në vendin e pestë (5) në klasa;
- Auto Garat malore: nga vendi parë (1) deri në vendin e pestë (5) në klasa ose në plasmanin e përgjithshëm;
- Auto Garat Reli: nga vendi parë (1) deri në vendin e pestë (5) në klasa ose në plasmanin përgjithshëm;
- Auto Garat Kros: nga vendi parë (1) deri në vendin e pestë (5) në klasa;
- Auto Garat Sllalom: nga vendi parë (1) deri në vendin e pestë (5) në klasa;
- Auto Garat – Dragster: nga vendi parë (1) deri në vendin e pestë (5) në klasa;
- Auto Garat Reli me automjeteve te terrenit: nga vendi parë (1) deri në vendin e pestë (5) në klasa ose në plasmanin përgjithshëm; dhe
- Karting: nga vendi parë (1) deri në vendin e pestë (5) në klasa;

Përveç kushteve të mësipërme, licencë mund të lëshohet të gjithë atyre të cilët kanë përfunduar shkollën e vozitjes sportive e cila është e pranuar nga FIA dhe CIK.

Neni 7.

Licencë e kategorisë B lëshohet vozitësve për rezultatet e arritura jashtë rezultateve të përcaktuara në nenin 6. dhe vozitësve të cilët posedojnë licencën paraprake të lëshuar nga klubi amë.

FASK nuk do të lëshojë licencë të rangut nacional për vozitësit e rinj para se vozitësi të posedojë një licencë të klubit amë.

Neni 8.

Pamja e licencës është si vijon:

Në pjesën e përparme është stema e FASK-ut, "Federata e Auto Sporteve te Kosovës", "Licencë e garuesit", "Numër", "Dega", "Polisa", "e vlefshme deri më", "Kategoria", "Emri dhe Mbiemri", "Numri ID", "Klubi" dhe foto. Në pjesën e pasme shkruan "Hyrja dhe parkimi falas në të gjitha Auto dhe Kartingut gara".

Neni 9.

Licenca lëshohet vetëm në bazë të kërkesës me shkrim të vozitësit nëpërmjet klubit për disiplinën përkatëse.

Kërkesa për lëshimin paraqitet në formularin e paraparë dhe vozitësi është i detyruar të sigurojë të gjithë shënimet të kërkuara në formular.

Së bashku me kërkesë duhet të bashkëngjitet fotografia, kopja e letërnjoftimit të lëshuar nga MPB të RKS, së bashku me origjinalin e letërnjoftimit për verifikim (për ata që nuk kanë letërnjoftim - certifikata e lindjes), një fotokopje e certifikatës mjekësore jo më e vjetër se 30 ditë, policia e sigurimit, pëlqimi i vërtetuar i Auto Klubit në rastin e ndryshimit të klubit, pëlqimi i prindit ose kujdestarit të vërtetuar te noteri ose organi kompetent për vozitësit nën 18 vjet dhe dëshmia e pagesës së anëtarësisë për lëshimin e licencës.

**Neni 10.**

Licenca lëshohet në afat kohor të përcaktuar sipas policës së sigurimit dhe me skadimin e policës së sigurimit skadon edhe licenca, kjo vlen nëse është e bashkangjitur kopja e policës së sigurimit.

Nëse kopja e policës së sigurimit nuk është e bashkangjitur, afati kohor regjistrohet deri më 31.12. të vitit aktual. Afati për dorëzimin e kërkesave për licencim është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para fillimit të garës së parë për disiplinë e përkatëse.

Neni 11.

E drejta e fituar për licencë nuk humbet, pa marr parasysh nëse vozitësi është marrë në mënyre aktive me Auto dhe karting sport.

Neni 12.

Licenca e Sponsoreve do të lëshohet të gjithë sponsorëve me një kërkesë me shkrim, siç parashikohet në Rregulloren Shtesë për çdo disiplinë si dhe pagesës së anëtarësisë.

REGJISTRIMI I VOZITËSVE DHE GARUESVE**Neni 13.**

Regjistrimi dhe licencimi bëhet për çdo disiplinë ndaras. Brenda një viti, vozitësi mund të regjistrohet dhe përfaqëson disa Klube sipas disiplinave dhe gjatë vitit ai nuk mund t'i ndërroj ato.

NDËRIMI I KLUBIT (AMK/SHAM/AK)**Neni 14.**

Vozitësit mund të ndërron klubin, vetëm në periudhë nga 1 janari deri në 15 ditë para garës së paraparë e cila është e miratuar në kalendarin e garave sipas disiplinave përkatëse, përveç nëse klubi për të cilën ai ka licencë, pushon të vepruarit.

Neni 15.

Vozitësi mund të kalon në Klubin tjetër vetëm nëse posedon fletë lëshimin me shkrim nga Klubi të cilën e ka përfaqësuar në vitin e kaluar për disiplinën përkatëse. Në fletë lëshimin duhet të ceket se vozitësi nuk ka ndonjë obligim financiar ose ndonjë obligim tjetër ndaj Klubit nga i cili vjen dhe që mund të kalon në një tjetër Klub. Klubi është i obliguar të lëshojë fletë lëshim në kërkesë të vozitësit, nëse vozitësi nuk ka ndonjë obligim material. Nëse Klubi amë, refuzon lëshimin e fletë lëshimit me kërkesë të vozitësit, i cili e ka paraqitur kërkesën në afat e duhur kohor, kontesti do të zgjidhët nga Bordi Drejtues i FASK-ut.

PARAQITJE PËR GARA**Neni 16.**

Garuesit dhe vozitësit paraqiten për pjesëmarrje në Kampionatin Kombëtar të Kosovës, sipas afateve të përcaktuara nga organizatori, në bazë të Rregullores së garave. Fletëparaqitjet dorëzohen në formularët të cilët janë pjesë përbërëse e Rregullores së garave. Aplikimet duhet të nënshkruhen nga vozitësit dhe të vërtetohen nga Klubi.

Mënyra e paraqitjes së ekipeve rregullohet në bazë të Rregulloreve Shtesë për vitin aktual.

Me nënshkrimin e fletë paraqitjeve, garuesit dhe vozitësit deklarojnë se janë të informuar me Rregulloren e garave dhe do të vozisin në përgjegjësin personale dhe heqin dorë nga të drejtat për kompensimin e dëmeve të automjetit ose në rasti të lëndimit, përveç nëse dëmtimi apo lëndimi është shkaktuar për shkak të gabimit apo lëshimit të organizatorit.

Neni 17.

Me paraqitjen e kërkesës nga garuesit dhe vozitësit dhe me pranimin e kërkesës nga ana e organizatorit, garuesit dhe vozitësit zyrtarisht marrin statusin e pjesëmarrësve në garë për Kampionatin Kombëtar të Kosovës dhe nga ai moment fillojnë obligimet reciproke kontraktuale të cilat duhet të zbatohen si nga ana e garuesit dhe vozitësit po ashtu edhe nga ana e organizatorit.



2016

Rregullore e veçantë të obligimeve të vozitësve dhe garuesve

PJESËMARRJA NË GARA JASHTË VENDIT DHE DHËNIE E LEJEVE

Neni 18.

Për pjesëmarrje individuale në Auto dhe Karting garat jashtë vendit, vozitësit duhet të kërkojnë miratim nga FASK-u përmes Klubit amë.

Së bashku me kërkesën duhet të cekin emërtimin e garës, vendin, shtetin dhe datën e mbajtjes së garës, si dhe automjetin me të cilin do të merr pjesë në këtë garë. Lejet për pjesëmarrje në garat jashtë vendit lëshohen nga FASK-u.

Leja për të marr pjesë në garat jashtë vendit nuk mund të lëshohet për garat të cilat nuk janë të regjistruara në kalendarin ndërkombëtar të FIA dhe CIK, përveç garave me ftesë.

Neni 19.

Lejet për pjesëmarrje në gara jashtë vendit lëshohen në baze të formularit të paraparë, e cila përmban emrin e garuesit dhe vozitësit, adresën, gara për të cilën është lëshuar leja, data e mbajtjes së garës, vendi, automjetin me të cilin do të merr pjesë në këtë garë si dhe numri i licencës ndërkombëtare.

KOMBËTARJA E FASK-ut.

Neni 20.

Përbërja e ekipit Kombëtarë të Kosovës përcaktohet nga Bordi i Drejtoreve Ekzekutiv të FASK-ut.

Përfaqësuesja Kombëtare nuk mund të marr pjesë në garat të cilat nuk janë të regjistruar në kalendarin ndërkombëtar të FIA-s dhe CIK.

PAJISJET PËR AUTO DHE KARTING GARA

Neni 21.

Gjatë trajnimeve dhe garave për Kampionatin Kombëtar të Kosovës, vozitësit obligohen të mbajnë pajisjet të përcaktuara sipas Rregullores Shtesë për vitin aktual.

SIGURIMI

Neni 22.

Për çdo Auto dhe karting garë në Kampionatin Kombëtar të Kosovës, vozitësit janë të obliguar të pajisen me policen e sigurimit, në bazë të kushteve të përcaktuara në Rregulloren Shtesë për vitin aktual për secilën disiplinë.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 23.

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen sipas të njëjtës procedurë e cila vlen edhe për nxjerrjen e saj, nga ana e Bordit të Drejtoreve Ekzekutiv të FASK-ut

Të drejtën e shpjegimit të dispozitave të kësaj Rregulloreje, e ka Bordi i Drejtoreve ekzekutiv të FASK-ut.

Neni 24.

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj 02.04.2016

FEDERATA E AUTO SPORTEVE TË KOSOVËS




Ismet Rexhepi, kryetar i FASK-ut